

LIGJI NR. 08/L-103**LIGJ PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE DHE SKEMËN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË****Kuvendi i Republikës së Kosovës**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE DHE SKEMËN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të komunave përmes matjes së performancës së komunave në ushtrimin e kompetencave vetanake, duke garantuar në të njëjtën kohë mbështetje financiare të bazuar në nivelin e arritur të shërbimeve të ofruara.
2. Përmes këtij ligji përcaktohen parimet, rregullat, procedurat dhe standardet e matjes të performancës së komunave, si dhe funksionimi i grantit të bazuar në performancë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon Sistemin për Menaxhimin e Performancës së Komunave dhe Grantin për Performancë të Komunave, që zbatohet nga komunat dhe udhëhiqet nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Fjalët apo shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Granti i Performancës së Komunave (GPK)** – instrument financiar me karakter stimulues që i'u ndahet komunave bazuar në performancën e tyre;
 - 1.2. **Dokumenti Kryesor i SMPK-së** – dokumenti që përshkruan konceptet themelore të ndërtimit dhe funksionimit të SMPK-së, hapat dhe procesin e matjes së performancës së komunave, përmbajtjen e fushave, rezultateve dhe treguesve të performancës, si dhe dokumentet tjera përcjellëse për zbatimin e SMPK-së;
 - 1.3. **Komunë** - njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës;
 - 1.4. **Kontributdhënës të grantit** –institucionet shtetërore, donatorët nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile;
 - 1.5. **Koordinatori për performancë të komunës** – zyrtari përgjegjës të komunës me detyrë për të koordinuar procesin e raportimit të performancës në komunë;
 - 1.6. **Matje e performancës** – metodë për nxjerrjen e të dhënave për tregues në raport me shkallën referente të përcaktuar në dokumentet e SMPK-së;

1.7. **Ministria** – ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale;

1.8. **Performancë e komunave** –niveлин e të arriturave të komunave në kuadër të një apo më shumë fushave të kompetencave të tyre, si rezultat i një procesi standard të mbledhjes, analizimit, verifikimit dhe raportimit të të dhënave;

1.9. **Palë e interesit** – ministritë, komunat, kontributdhënësit, shoqëria civile dhe qytetarët;

1.10. **Rregullat e grantit për performancë të komunave** –sistemi i rregullave të veçanta të aprovuara nga Ministria me akt nënligjor, me të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e vlerësimit të komunave për qëllim të përfitimt nga skema e grantit për performancë të komunave;

1.11. **SMPK** - Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave.

KAPITULLI II PARIMET E PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE DHE SKEMËS SË GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË

Neni 4 Parimi i ligjshmërisë

Institucionet veprojnë në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe rregullat administrative për matjen e performancës së komunave dhe ndarje të grantit për performancë.

Neni 5 Parimi i transparencës

Institucionet ndjekin një qasje të hapur për qytetarët dhe palët e tjera të interesit lidhur me performancën e komunave dhe menaxhimin e skemës së grantit për performancë.

Neni 6 Parimi i subsidiaritetit

Matja e performancës shtrihet për aq sa është e mundur tek ofruesit më të afërt të shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe ndikimi i grantit reflekton interesat dhe nevojat e qytetarëve të komunës.

Neni 7 Parimi i meritës

1. Niveli i performancës së arritur ndikon në radhitjen e komunave sipas rezultateve të treguara në ushtrimin e kompetencave në fushat e matura.

2. Granti i performancës së komunave merr parasysh nivelin e performancës së arritur të komunave si dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara me rregulla të veçanta.

Neni 8 Parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë

Institucionet përgjegjëse duhet të raportojnë dhe vlerësojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme.

Neni 9 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

Institucionet përgjegjëse veprojnë në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Komunat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Institucionet përgjegjëse në mënyrë të veçantë shmangin çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet në ligjin kundër diskriminimit.

KAPITULLI III PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE PËR MENAXHIMIN E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE

Neni 10

Institucionet përgjegjëse për matje të performancës së komunave

1. Ministria është institucion përgjegjës për matjen e performancës së komunave. Ministria në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore dhe komunat koordinon procesin e zhvillimit dhe zbatimit të SMPK-së.
2. Komunat janë subjekte të matjes së performancës në pajtim me rregullat e SMPK-së të përcaktuara në këtë ligj dhe me akt nënligjor.
3. Ministria dhe komunat sigurojnë resurset e nevojshme për zbatimin e procesit të matjes së performancës, përmes strukturave përgjegjëse për performancë të komunave.

Neni 11

Përgjegjësitë e ministrisë

1. Ministria është institucion përgjegjës për menaxhimin e SMPK-së dhe Grantit për Performancë të Komunave.
2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, ministria:
 - 2.1. Harton aktet nënligjore dhe dokumente të politikave për zbatimin efikas të dispozitave të këtij ligji;
 - 2.2. Zhvillon kapacitete të mjaftueshme për SMPK dhe grantin për performancë të komunave, përmes njësisë përgjegjëse për performancë;
 - 2.3. Harton dhe përditëson Dokumentin Kryesor të SMPK-së, në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore, komunat dhe kontributdhënësit;
 - 2.4. Udhëheq procedurat e mbledhjes, përpunimit, verifikimit dhe raportimit të të dhënave të performancës;
 - 2.5. Administron sistemin informativ elektronik, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit;
 - 2.6. Udhëheq procesin e vlerësimit dhe ndarjes së grantit për performancë të komunave.

Neni 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës

1. Komuna është përgjegjëse për funksionimin efikas të Sistemit të Menaxhimit të Performancës në komunë. Në këtë drejtim komuna ka këto përgjegjësi:
 - 1.1. Bashkëpunon me ministrinë për ndërtimin, zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të matjes së performancës së komunave;
 - 1.2. Mbledh, verifikon dhe raporton të dhënat për performancën e komunës në pajtim me Dokumentin Kryesor;
 - 1.3. Adreson rekomandimet e raportit të performancës në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe qeverisjes;
 - 1.4. Cakton strukturat përgjegjëse për menaxhim të procesit të performancës në komunë.

Neni 13
Njësia përgjegjëse për performancë në Ministri

Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe granti për performancë, menaxhohen nga Njësia përgjegjëse për performancë të komunave në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 14
Strukturat e matjes të performancës në komunë

1. Matja e performancës në nivel të komunës udhëhiqet nga kryetari i komunës.
2. Në çdo komunë, kryetari me vendim cakton zyrtarët përgjegjës raportues për fushat e performancës së komunës, si dhe koordinatorin për performancë të komunës.
3. Koordinatorin dhe zyrtarët raportues duhet të jenë persona nga radhët e shërbimit civil dhe të kenë integritet të lartë, si dhe kompetencë profesionale në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi për koordinimin e procesit të matjes së performancës në komunë.

Neni 15
Detyrat e koordinatorit për performancë të komunës

Koordinatori për performancë është përgjegjës për koordinimin e procesit të raportimit me zyrtarët raportues të fushave të SMPK-së, zbatimin e kriterëve për verifikim dhe raportimin e të dhënave të cilat i dërgohen kryetarit të komunës për miratim.

Neni 16
Lirimi nga detyra i koordinatorit dhe zyrtarëve raportues

1. Koordinatorin për performancë lirohet nga detyra në këto raste:
 - 1.1. Nuk zbaton kriteret e nenit 22 të këtij ligji në lidhje me sigurimin e cilësisë së të dhënave;
 - 1.2. Nuk respekton parimet e matjes së performancës të përcaktuara me këtë ligj;
 - 1.3. Raporton me vonesë dhe neglizhon në mënyrë të vazhdueshme procesin e matjes së performancës;
 - 1.4. Me kërkesë të vetë koordinatorit me miratim nga kryetari.
2. Kriteret për caktim dhe shkarkim aplikohen përshtatshëmrisht edhe për zyrtarët raportues të fushave të matjes së performancës.
3. Në rast të lirimit nga detyra të koordinatorit dhe zyrtarëve raportues, kryetari i komunës brenda afatit prej 15 ditësh, cakton zyrtarët e tjerë për ushtrimin e këtyre funksioneve.

KAPITULLI IV
SISTEMI I MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE

Neni 17
Elementet përbërëse të SMPK-së

1. Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Komunave është instrument për vlerësimin e performancës së komunave bazuar në fusha, tregues dhe të dhëna.
2. Fushat, treguesit dhe të dhënat të cilat janë pjesë e SMPK-së bazohen në kompetencat vetanake të komunave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe legjisllacionin përkatës në fuqi.
3. Përfshirja e kompetencave vetanake në SMPK bëhet sipas kriterëve të qarta, të matshme, të arritshme dhe jodiskriminuese për komunat.

4. Gjatë zhvillimit dhe rishikimit të SMPK-së Ministria bashkëpunon me palë të tjera të interesuara përfshirë: ministritë e linjës, komunat, institucionet e tjera të administratës shtetërore, donatorët dhe shoqërinë civile.

5. Ministria me akt nënligjor përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e zhvillimit dhe rishikimit të SMPK-së.

Neni 18

Sistemi Elektronik për Performancë të komunave

Ministria krijon Sistemin Elektronik të Performancës në pajtim me elementet përbërëse të Sistemit të Menaxhimit të Performancës së Komunave.

KAPITULLI V

MATJA E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE

Neni 19

Procesi i matjes së performancës

1. Matja e performancës së komunave është proces që organizohet në baza të rregullta vjetore nga ministria.

2. Afati i raportimit të të dhënave të performancës nga komunat është jo më shumë se dyzet e pesë (45) ditë nga momenti i dorëzimit të kërkesës për raportim nga ministria.

3. Procedurat e matjes dhe afatet tjera përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 20

Menaxhimi i procesit në komunë

1. Kryetari i Komunës është përgjegjës për menaxhimin e matjes së performancës në komunë dhe siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret e cilësisë së të dhënave të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e tjera për menaxhim të procesit të matjes së performancës përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë.

Neni 21

Matja e performancës së komunave nga ministria

1. Njësia për performancë komunale është përgjegjëse për matjen e performancës së komunave, pas pranimit të të dhënave të raportuara nga komuna.

2. Njësia për performancë siguron përmbushjen dhe zbatimin e kriterëve të cilësisë së të dhënave të përcaktuara me nenin 22 të këtij ligji.

Neni 22

Cilësia e të dhënave të performancës

1. Të dhënat e raportuara për performancë duhet të jenë të sakta, të plota, të qarta, të dokumentuara dhe të pasqyrojnë në mënyrë reale performancën e komunës.

2. Ministria harton metodologji unike për sigurimin e cilësisë së të dhënave në kuadër të Dokumentit Kryesor.

Neni 23

Pavlefshmëria e të dhënave dhe masat përjashtuese

1. Të dhënat të cilat nuk i përmbushin kriteret e cilësisë konsiderohen si të dhëna të pavlefshme.

2. Në rast se gjatë procesit të verifikimit vërtetohet se një komunë ka raportuar të dhëna të pasakta në krahasim me dokumentet referuese dhe që rezulton në performancë më të lartë, performanca e asaj komune në fushën për të cilën të dhënat janë të pasakta, shpallet e pavlefshme.

3. Në rast se vërtetohet se një komunë ka raportuar të dhëna të pasakta apo fiktive të cilat ndikojnë rritjen e performancës në treguesit e Grantit të Performancës, e njëjta përjashtohet nga e drejta për të përfituar nga ky grant në vitin e alokimit.

Neni 24 **E drejta për ankesë**

1. Komunitat kanë të drejtën e ofrimit të vërejtjeve ose parashtrimit të ankesës rreth vlerësimit të performancës, brenda afatit prej shtatë (7) ditë pune nga dita e komunikimit të rezultateve.

2. Ankesa shqyrtohet nga komisioni i ankesave të performancës, i themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë dhe përbëhet prej tre (3) anëtareve nga Ministria me të drejtë vote duke respektuar kriterin e përfaqësimit gjinor. Procesi i shqyrtimit të ankesave është i hapur për shoqërinë civile dhe donatorët në cilësinë e vëzhguesve.

3. Komisioni i ankesave të performancës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas mbylljes së afatit për pranimin e ankesave të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nxjerr vendim në lidhje me ankesën e komunës. Vendimi i Komisionit është i plotfuqishëm dhe nuk mund të ndryshohet.

Neni 25 **Aprovimi dhe publikimi i rezultateve të performancës së komunave**

1. Njësia përgjegjëse e Ministrisë zbaton vendimet e komisionit të ankesave në raportin e performancës së komunave.

2. Raporti vjetor i performancës publikohet me aprovim të Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë në ueb-faqen zyrtare të ministrisë dhe të komunave në gjuhët zyrtare, jo më vonë se deri me 31 maj të atij viti kur bëhet vlerësimi.

KAPITULLI VI **GRANTI PËR PERFORMANCË TË KOMUNAVE**

Neni 26 **Qëllimi i grantit**

Granti për Performancë të Komunave ka për qëllim stimulimin e komunave që të përmirësojnë performancën në ofrimin e shërbimeve publike në fusha të caktuara.

Neni 27 **Financimi i grantit**

1. Granti për Performancë të Komunave përbën një formë të veçantë të përkrahjes financiare për komunitat nga Buxheti i Kosovës dhe është i hapur për fondet e tjera të kontributdhënësve.

2. Grantit për Performancë duhet të jetë në lartësi deri në dy pikë pesë përqind (2.5 %) e grantit të përgjithshëm të komunave, të përcaktuar me Ligjin për financat lokale nga Buxheti i Kosovës, për secilin vit fiskal.

3. Lartësia e grantit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, merr si referencë vetëm vlerën e grantit të përgjithshëm të komunave dhe nuk merret nga ky grant, por nga ndarjet e tjera të buxhetit të Kosovës.

4. Granti për performancë alokohet në buxhetin e Ministrisë konform ligjit vjetor për ndarjet buxhetore.

Neni 28**Organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës së komunave**

1. Komisioni i grantit të performancës së komunave dhe grupi teknik janë organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës së komunave.
2. Komisioni i Grantit të Performancës së Komunave është organ vendimmarrës dhe themelohet me vendim të ministrit të Ministrisë, në përbërje si vijon:
 - 2.1. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë;
 - 2.2. Një nëpunës civil i nivelit drejtues të ministrisë;
 - 2.3. Një nëpunës civil nga ministria përgjegjëse për financa.
3. Në Komisionin e Grantit të Performancës kanë të drejtë të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve përfaqësues nga ministrinë e tjera, organizatat kontributdhënëse dhe shoqëria civile.
4. Grupi Teknik është organ i nivelit profesional i përbërë nga zyrtarë publik të njësive përgjegjëse për performancë komunale apo njësive të tjera organizative brenda ministrisë, si dhe nga përfaqësues të subjekteve kontributdhënëse, i cili themelohet me vendim të sekretarit të përgjithshëm, përbërja e të cilit përcaktohet me akt nënligjor.
5. Komisioni i ankesave është organ i themeluar me vendim të Ministrit, përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen për ankesat e parashtruara nga komunat lidhur me vlerësimin e performancës për grant. Komisioni i ankesave ka përbërjen si vijon:
 - 5.1. Dy (2) zyrtarë publik nga Ministria (njëri kryesues);
 - 5.2. Një (1) përfaqësues nga shoqëria civile.
6. Anëtarët e komisionit të grantit, grupit teknik për vlerësim të grantit dhe komisionit të ankesave për vlerësim të performancës, nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të ankesave për grantin e performancës.
7. Detyrat dhe përgjegjësitë e organeve përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës së komunave përcaktohen me akt nënligjor të ministrisë.

Neni 29**Rregullat e grantit për performancë**

1. Rregullat e grantit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.
2. Rregullat e grantit përfshijnë përcaktimin e objektivave të grantit, kushteve minimale, sistemin e treguesve që mund të aplikohen në ciklet e vlerësimit, formulën e llogaritjes së vlerave të grantit, afatet, burimin e të dhënave dhe aspektet e sigurimit të cilësisë së tyre, si dhe çështje të tjera procedurale të grantit.
3. Skema e treguesve të grantit të performancës ashtu siç përcaktohet rregullat e grantit nuk mund të ndryshohet në një periudhë më të shkurtër se 3 vite nga hyrja në fuqi e tyre.
4. Treguesit e grantit të performancës bazohen në rezultatet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës së Komunave.

Neni 30**Qasja në grant**

1. Të gjitha komunat kanë të drejtë të kenë qasje në grantin e performancës së komunave sipas kriterëve të përcaktuara në rregullat e grantit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 23 të këtij ligji.

2. Komunitat përfitojnë lartësinë e caktuar të grantit bazuar në formulën e llogaritjes së grantit të përcaktuar në nenin 32 të këtij ligji.

Neni 31 **Procedura e vlerësimit për grant**

1. Vlerësimi i komunave për grantin e performancës fillon pas publikimit të raportit vjetor të performancës së komunave për vitin paraprak.
2. Ministria e njofton komunën për rezultatin e vlerësimit të grantit të performancës brenda shtatë (7) ditëve pas aprovimit të raportit vlerësues nga Komisioni i Grantit të Performancës.
3. Komunitat kanë të drejtën e ankesës ndaj raportit përfundimtar të vlerësimit për grant, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga data e pranimit të njoftimit sipas paragrafit 2 të këtij neni.
4. Komisioni i ankesave të grantit të performancës brenda shtatë (7) ditë pune prej ditës së mbylljes së afatit për ankesa, nxjerr vendim në lidhje me ankesën e komunës. Vendimi i Komisionit të ankesave është i plotfuqishëm dhe nuk mund të ndryshohet.
5. Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Ministria i komunikon rezultatet përfundimtare të grantit të performancës të komunës, duke përfshirë lartësinë e fituar të këtij granti nga secila komunë i cili alokohet në vitin vijues. Rezultatet duhet të publikohen më së voni deri me 1 gusht.
6. Të gjitha çështjet e tjera procedurale të vlerësimit të grantit përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 32 **Llogaritja e shumës së grantit të performancës**

1. Nëntëdhjetë për qind (90%) e shumës së përgjithshme të Grantit për Performancë të Komunave ndahet bazuar në formulën si vijon:
 - 1.1. Në bazë të performancës relative të secilës komunë, të matur sipas treguesve të grantit të performancës së komunave;
 - 1.2. Peshës së grantit të performancës së komunave në raport me grantin e përgjithshëm të komunave të alokuar.
2. Dhjetë për qind (10%) e shumës së përgjithshme të Grantit të Performancës së Komunave ndahet si shpërblim shtesë për komunitat në tre (3) vendet e para me performancën më të mirë.
3. Kriteret e detajuara të formulës për llogaritjen e grantit përcaktohen me akt nënligjor të ministrisë.

Neni 33 **Menaxhimi i fondeve të grantit të performancës**

1. Menaxhimi i fondeve të grantit të performancës udhëhiqet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Menaxhimi i fondeve të grantit të performancës nga pjesa e kontributdhënësve përcaktohet me marrëveshje në mes të palëve.
3. Granti i performancës duhet të shpenzohet në kategorinë e investimeve kapitale.

Neni 34 **Aktet nënligjore**

Ministria brenda afatit prej 6 muajsh prej hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr aktin nënligjor për zbatimin e këtij ligji.

Neni 35
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës dhe Skemës së Grantit të bazuar në Performancë.

Neni 36
Dispozitat kalimtare

Procedurat e filluara për matjen e performancës dhe vlerësimin për grant para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vendosen dhe përfundojnë në pajtim me rregullat juridike paraprake në fuqi.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-103
21 korrik 2022

Shpallur me dekretin Nr. DL-253/2022, datë 08.08.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu